REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK, OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 5-18/82C
Nr. i faq.
Data 07/10/2026

Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna Junik – Opština Junik – Municipality of Junik

RAPORT NGA KONSULTIMI PUBLIK PËR STRATEGJINË PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL 2026 – 2033

07.10.2026

Hyrje

Ky raport është përgatitur në kuadër të procesit të konsultimit publik për Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026 – 2033 të Komunës së Junikut, me qëllim të dokumentimit të procesit të konsultimit, pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të interesuara, si dhe të komenteve, propozimeve dhe sugjerimeve të pranuara gjatë këtij procesi.

Konsultimi publik ka për qëllim të mundësojë përfshirjen e qytetarëve dhe palëve të interesuara në shqyrtimin e prioriteteve, objektivave dhe aktiviteteve të parapara me Strategjinë, si dhe të kontribuojë në përmirësimin dhe finalizimin e dokumentit.

Baza ligjore

Procesi i konsultimit publik është zhvilluar duke u bazuar në:

- Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale;
- Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë;

Në veçanti, takimi konsultativ me qytetarë dhe palët e interesuara është organizuar në përputhje me Nenin 29 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023, i cili rregullon takimet konsultative me publikun.

Informacione për konsultim publik

Dokumenti objekt i konsultimit:
Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026 – 2033

Komuna: Junik

Periudha e konsultimit publik:
20.08.2026 – 20.09.2026

Takimi konsultativ:
18.09.2026

Ora: 10:00

Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut

Takimi konsultativ është organizuar brenda periudhës së konsultimit publik dhe njoftimi për mbajtjen e tij është publikuar më 08.09.2026, ndërsa takimi është caktuar për 18.09.2026.

Në njoftimin publik janë ftuar qytetarët dhe kategoritë kryesore të palëve të interesuara, përfshirë bizneset, fermerët, sektorin e turizmit dhe gastronomisë, të rinjtë, shoqërinë civile, mërgatën, investitorët potencialë dhe përfaqësuesit e bashkësive lokale.

Publikimi dhe informimi i publikut

Njoftimi për organizimin e takimit konsultativ është publikuar nga Komuna e Junikut më datë 08.09.2026, me qëllim të informimit të qytetarëve dhe palëve të interesuara për datën, kohën dhe vendin e takimit, si dhe për dokumentin objekt të konsultimit.

Krahas njoftimit, qytetarët janë informuar për mundësinë e paraqitjes së komenteve, propozimeve, vërejtjeve dhe sugjerimeve lidhur me Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026 – 2033.

Strategjia dhe materialet relevante janë bërë të qasshme për publikun përmes ueb-faqes zyrtare të Komunës së Junikut.

Takimi konsultativ me qytetarët dhe palët e interesuara

Më datë 18.09.2026, në ora 10:00, në Sallën e Kuvendit të Komunës së Junikut, është mbajtur takimi konsultativ për Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026 – 2033.

Gjatë takimit janë prezantuar:
- qëllimi dhe rëndësia e Strategjisë;
- gjendja dhe potencialet zhvillimore të Komunës së Junikut;
- sfidat kryesore të zhvillimit ekonomik lokal;
- vizioni dhe misioni i Strategjisë;
- pesë prioritetet kryesore të zhvillimit:

1. Arsimi;
2. Infrastruktura;
3. Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale;
4. Bujqësia dhe Zhvillimi Rural;
5. Turizmi dhe Trashëgimia Kulturore;

Si dhe porientimet për zbatimin e Strategjisë për periudhën 2026–2033 dhe Plani i Veprimit për periudhën 2026–2028.

Pjesëmarrësit kanë pasur mundësinë të paraqesin komente, propozime, vërejtje dhe sugjerime lidhur me përmbajtjen e Strategjisë.

Pjesëmarrja në takim

Tabela me të dhëna nga takimi konsultativ

Metoda e konsultimit	Data	Numri i pjesëmarrësve	Numri i komenteve/ propozimeve	Numri i kërkesave të pranuara
Takim konsultativ me qytetarë dhe palët e interesuara	18.09.2026	10	0	0
Komente të pranuara përmes e-mailit	20.08.2026 – 20.09.2026	0	0	0
Gjithsej		10	0	0

Komentet, propozimet dhe sygjerimet e pranuara

Nr.	Komenti / Propozimi / Sugjerimi	Kush e ka paraqitur	Statusi	Arsyetimi / Përgjigjja
1	///	///	Pranohet / Pjesërisht / Refuzohet	///
2	///	///	Pranohet / Pjesërisht / Refuzohet	///
3	///	///	Pranohet / Pjesërisht / Refuzohet	///
4	///	///	Pranohet / Pjesërisht / Refuzohet	///
5	///	///	Pranohet / Pjesërisht / Refuzohet	///

Rezultatet e konsultimit publik

Gjatë procesit të konsultimit publik, Komuna e Junikut nuk ka pranuar asnjë koment, asnjë propozim dhe asnjë sugjerim lidhur me Strategjinë për Zhvillim Ekonomik 2026 – 2033.

Përfundim

Procesi i konsultimit publik për Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026 – 2033 ka mundësuar përfshirjen e qytetarëve dhe palëve të interesuara në shqyrtimin e prioriteteve, objektivave dhe aktiviteteve të parapara për zhvillimin ekonomik të Komunës së Junikut.

Komuna e Junikut vlerëson kontributin e qytetarëve, bizneseve, fermerëve, sektorit të turizmit, të rinjve, shoqërisë civile dhe palëve të tjera të interesuara që kanë kontribuar me komente dhe propozime gjatë procesit.

Meqenëse gjatë procesit të konsultimit publik nuk janë pranuar komente, propozime apo sugjerime, nuk ka pasur kërkesa për ndryshime në Draft - Strategji.

Dokumentet e bashkëngjitura

Bashkëngjitur këtij raporti janë:

1. Njoftimi për hapjen e konsultimit publik për Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026 – 2033
   Linku - https://junik.rks-gov.net/raporti-financiar-tm1-per-vitin-2026?jd_folder=1567
   Emri i dokumentit në Publikim: Njoftim për diskutim publik për Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal (SZHEL) 2026 - 2033

2. Njoftimi për mbajtjen e takimit konsultativ
   Linku - https://junik.rks-gov.net/raporti-financiar-tm1-per-vitin-2026?jd_folder=1567
   Emri i dokumentit në Publikim - Njoftim për Takim Konsultativ për Strategjinë për zhvillim ekonimik lokal 2026 – 2033.

3. Materiali/Prezantimi i përdorur gjatë Diskutimit/takimit
   Linku - https://junik.rks-gov.net/raporti-financiar-tm1-per-vitin-2026?jd_folder=1567
   Emri i dokumentit në Publikim: 04. Draft - Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026 - 2033

4. Lista e pjesëmarrësve në takimin konsultativ

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna Junik - Opština Junik - Municipality of Junik

"Takim konsultativ për Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026–2033 në Komunën e Junikut

Data: 18.09.2026

Ora: 10:00

Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës

Lista e pjesëmarrësve

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Emri i biznesit	Nënshkrimi
1	HAKI JASHARI	ARDI SHPK	049/208/362
2	Mehdi Kuqi	Qytetar	044/208-8[illegible]
3	Esat Hoxha		049/253-337
4	Mevlud Veliu	OJQ RS - koordinator	044 890 917
5	Fatos Shala	DSHMS	044 286 304
6	ZEKUN SHALA	DUKM	044/61-809
7	Demokrat Gamiqi	Shoqëria Publike	049-409-100
8	Besart Tafaj	/	
9	Florentina Qeriqi	/	
10	Jaki Jakaj	/	044-178-73
11			
12			
13			

5. Procesverbali nga takimi konsultativ



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



PROCESVERBAL

Nga takimi konsultativ publik për Draft-Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026 – 2033

Data: 18.09.2026

Ora e fillimit: 10:00

Ora e përfundimit: 10:30

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal të Junikut

1. Qëllimi i takimit

Takimi konsultativ publik është organizuar me qëllim të prezantimit të Draft - Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026–2033 të Komunës së Junikut, si dhe ofrimit të rundësisë për qytetarët, bizneset dhe palët e tjera të interesuara që të paraqesin pyetje, vërejtje, komente dhe sugjerime lidhur me përmbajtjen dhe prioritetet e Strategjisë.

2. Hapja e takimit

Takimi filloi në ora 10:00

Takimin e hapi z. Besart Tofaj, Nëpunësi për Informim i Komunës së Junikut dhe kryesues i takimit, i cili në fillim përshëndeti dhe falënderoi asistarët e Komunitetit për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026 – 2033, të cilët ishin të pranishëm në takim, si dhe pjesëmarrësit e tjerë për prezencë e tyre.

Kryesuesi theksoi rëndësinë e procesit të konsultimit publik dhe të përfshirjes së palëve të interesuara në hartimin e Strategjisë.

Në fillim të takimit, kryesuesi kërkoi që të prisej edhe 15 minuta, me qëllim që t'u mundësohej pjesëmarrja edhe përfaqësuesve të tjerë, veçanërisht nga komuniteti i biznesit dhe palët e tjera të interesuara.

3. Prezantimi i Draft - Strategjisë

Në ora 10:15, kryesuesi i takimit, z. Besart Tofaj, filloi prezantimin e Draft-Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026 – 2033.

Gjatë prezantimit u paraqitën në mënyrë të përmbledhur:

- qëllimi dhe rëndësia e Strategjisë;
- gjendja dhe potencialet zhvillimore të Komunës së Junikut;
- fushat kryesore të zhvillimit ekonomik lokal;
- vizioni dhe misioni i Strategjisë;
- pesë prioritetet kryesore të zhvillimit
  1. Arsimi;
  2. Infrastruktura;
  3. Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale;
  4. Bujqësia dhe Zhvillimi Rural;
  5. Turizmi dhe Trashëgimia Kulturore;
  6. Orientimet për zbatimin e Strategjisë për periudhën 2026–2033 dhe Planin e Veprimit për periudhën 2026 – 2028.

Prezantimi i Draft – Strategjisë përfundoi në ora 10:30.

4. Pyetjet, vërejtjet, komentet dhe sugjerimet

Pas përfundimit të prezantimit, kryesuesi e hapi diskutimin dhe ftoi pjesëmarrësit që të paraqesin pyetje, vërejtje, komente dhe sugjerime lidhur me Draft - Strategjinë.

Nga pjesëmarrësit nuk u paraqitën pyetje, vërejtje, sugjerime apo komente lidhur me Draft - Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026 – 2033.

5. Pjesëmarrja e palëve të interesuara

Gjatë takimit, kryesuesi bëri edhe një sqarim lidhur me rëndësinë për konsultimin publik, duke theksuar se së rëndësishmi është shfaqësitë formalisht "Grupi Punues", ndërsa formalisht i saktë duhet të jetë "Komisioni për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal".

Kryesuesi, z. Besart Tofaj, theksoi gjithashtu se fleta për pjesëmarrje në konsultimin publik ishte përcjellë te biznesi dhe te të gjitha palët e interesuara, të cilat prekeu drejtpërdrejt nga kjo Strategji.

Megjithatë, u theksua se pjesëmarrja e përfaqësuesve të biznesve dhe palëve të tjera të interesuara ishte e ulët. Ishte pasur parasysh shkëmbimi i komentuar të tyre në procesin e konsultimit publik dhe në harmoni e tyre dokumentin në një gjithëpërfshirës.


6. Përfundimi i takimit

Mungesën nuk pati pyetje, vërejtje, komente apo sugjerime nga pjesëmarrësit, gjo përfundimi të diskutimit, në ora 10:30, kryesuesi i takimit, z. Besart Tofaj, e shpalli takimin konsultativ publik të mbyllur.

Përgatiti:
Fatos Shala
Asistent i Komunës

Besart Tofaj
Kryesuesi i takimit

6. Njoftimi për diskutim publik



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Duke u bazuar në nenin 68, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Zyra e Kryetarit të Komunës, në bashkëpunim me Drejtorinë për Ekonomi dhe Zhvillim, njofton qytetarët se hapet për:

1~480/6561
20 / 08 / 2026

DISKUTIM PUBLIK

STRATEGJIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL 2026 - 2033

Duke pasur parasysh përmbushjen e kërkesave të qytetarëve dhe zbatimin e dispozitave ligjore, Komuna përdor mekanizmin e konsultimit publik dhe pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në procesin e hartimit dhe propozimit të vendimeve me interes për qytetarët.
Andaj, pas miratimit në lexim të parë në Kuvendin Komunal, më datë 31.07.2026, Zyra e Kryetarit, në bashkëpunim me Drejtorinë për Ekonomi dhe Zhvillim, e hap për diskutim publik Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026–2033.

nga data 20.08.2026 deri me 20.09.2026.

Vërejtjet, propozimet, sugjerimet dhe komentet tuaja mund t'i dorëzoni në Zyrën e Kryetarit, në objektin e Komunës apo në email: besart.tofaj@rks-gov.net. Ka mund të sigurohen edhe materiale për shqyrtim, çdo ditë pune, nga ora 08:00 deri në orën 17:00. Dokumentin mund ta gjeni edhe në faqen zyrtare të Komunës së Junikut.
Nga: Besart Tofaj – Nëpunës i Komunës – Këshilltar i Grupit Punues

Përmes: Rushdi Shehu – Kryetar i Komunës

Datë: 20.08.2026

7. Njoftimi për diskutim publik – takimi konsultativ



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

Zyra e Kryetarit & Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim
Datë: 08.09.2026

Duke u bazuar në nenin 68 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administrimë të Hapur në Komunë, **Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim bëjnë këtë:**

NJOFTIM PUBLIK

Komuna e Junikut ju fton të merrni pjesë në takimin konsultativ me qytetarë dhe palët e interesuara për Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026–2033, me qëllim të prezantimit dhe shqyrtimit të përbashkët të prioriteteve, objektiveve dhe aktiviteteve të parapara për zhvillimin ekonomik të Komunës së Junikut.

Në mbyrje të veçantë, fiohen të martin pjesë:
- përfaqësuesit e bizneseve lokale;
- fermerët dhe përfaqësuesit e sektorit të bujqësisë;
- përfaqësuesit e sektorit të turizmit dhe gastronomisë;
- të rinjtë dhe organizatat rinore dhe të shoqërisë civile;
- përfaqësuesit e mërgatës dhe investitorët potencialë;
- përfaqësuesit e bashkësive lokale;
- si dhe të gjithë qytetarët e interesuar të Komunës së Junikut.

Gjatë takimit do të prezantohen vizioni, objektivat strategjike, objektivat specifike dhe Plani i Veprimit të Strategjisë, ndërsa pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të japin komente, propozime, vërejtje dhe sugjerime lidhur me aktivitetet e parapara.

Kontributi i të gjithë qytetarëve është i rëndësishëm për të siguruar që Strategjia të pasqyrojë nevojat, sfidat dhe potencialet reale të Komunës së Junikut, si dhe të jetë sa më e zbatueshme në praktikë.

Data: 18.09.2026
Ora: 10:00
Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Për dërgimin e komenteve, propozimeve dhe sugjerimeve në formë elektronike mund ta bëni në e-mail: besart.tofaj@rks-gov.net

Pjesëmarrja dhe kontributi juaj janë të rëndësishëm për ndërtimin e një Strategjie të përbashkët për zhvillimin ekonomik të Junikut.

Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026–2033 dhe materialet tjera janë të publikuara në web-faqen zyrtare të Komunës së Junikut

Kryesuesi: Besart Tofaj

Ju nderëpresim!

8. Ftesa për bizneset



9. Prezantimi i strategjisë në diskutim publik – takimi konsultativ.



Përgaditi: Besart Tofaj